



PRIZREN

doors

EC
MA NDYSHE



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confédératziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)



PRIZREN doors

Botues: EC Ma Ndryshe

Autore: Valtida Shukriu Marseli

Rr. Fehmi Lladrovci, Nr. 94, Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

029-222-771 & 038-224-967

2019

Prizren Doors - Dyert e Prizrenit

HYRJE

Një kalim pragu të përcjellë drejt botës tënde të sigurt, aty ku edhe zhurma të jep qetësi, në shtëpi. Çdo udhëtim fillon me hapjen e një dere dhe përfundon me mbylljen e saj, për të filluar kështu me një udhëtim të ri. Dera është ajo që të pret e të përcjellë, është kontakti i parë drejt strehës tënde të ngrohtë dhe kontakti i fundit që të ndanë prej saj. Me të qëndruar përballë saj nuk do ta kuptosh dot ngrohtësinë që të pret në anën tjetër. Pas asaj dere fshihet një botë më vete, një histori, një kujtim, një familje. Ajo derë do të jetë mbrojtëse e botës që përmban, aq sa mikpritëse ndaj botës jashtë saj.

Secila pjesë e saj është e menduar dhe punuar në detaje të cilat është e

vështirë të kuptohen me të shikuar.

Çdo kujtim që është përcjellur brez më brez, i ka dhënë më shumë kuptim dhe vlerë shpirtrore secilit detaj që kanë kapur fotografitë.

Ndryshimet e shumta që ndeshen mes dyerve të asaj kohe dhe atyre të kohës së sotme prapë se prapë arrijnë në një pikë të përbashkët: dera do të mbyllët për të mbrojtur familjen që i përket, por do të jetë gjithmonë e hapur për mysafirët. Një trokitje në derë shënon një ardhje që pritet të sjell dicka nga jashtë, një frymë të re, një ngjarje, një emocion. Nën tingujt e lëvizjes së dorezës, që nga momenti i hapjes së asaj dere, do të filloj një tregim i ri.

METODOLOGJIA

DERA është një përbledhje e fotografive të dyerive të vjetra të realizuara për EC Ma ndryshe nga Valtida Shukriu Marseli. Këto dyer, të cilat vazhdojnë të jenë pjesë e qytetit të Prizrenit, promovojnë vlerat e trashëgimisë kulturore të qytetit dhe bashkë me shumë fotografi të tjera janë të prezantuara edhe në profilin e rrjeteve sociale "Prizren's doors and windows" të cilin e ka krijuar dhe e menaxhon Valtida Shukriu Marseli.

Ky katalog përfshin gjithsej 24 dyer të fotografuara, të përshkruara dhe të shoqëruara me nga një historik të shkurtër për secilën prej tyre. Secili detaj shpreh në vete dicka të vecantë dhe me plot kuptim, për t'i bërë dyert e kësaj periudhe sa unike, aq edhe të ngjajshme me njëra-

tjetrën.

Prizreni si qytet i identifikuar me trashëgiminë kulturore, përmes këtij katalogu paraqitet në një rrafsh kulturor, arkitektural dhe familjar duke u munduar të tregohet se si këto elemente ruhen me fanatizëm nga prizrenasit e sotëm.

Për të përcjellë një frymë sa më të fuqishme të asaj që përban katalogu është përfshirë edhe fjalorthi i termeve të pjesëve më karakteristike të këtyre dyerive dhe rubrika e fjalëve të urta.



Pamje e Prizrenit të lashtë

Burimi: i panjohur

Viti: i panjohur

FJALORTH

***Çoku-tak taku** – çekani është zilja e dorës mashkulllore. Në kohët e vjetra kur dikush trokiste në derë përmes tij kuptohej që tek dera është një mashkull.

***Parmaku-hallka** - rrezja e dorës është zilja femërore. Në kohët e vjetra kur dikush trokiste në derë përmes saj , kuptohej që tek dera është një femër.

***Shuli-rrezja** është përforcuesi i vendosur prapa derës, i punuar nga farkëtari zakonisht në formë të gjarprit, duke u lidhur me simbolikën pagane sipas së cilës gjarpri konsiderohej mbrojtësi i shtëpisë dhe familjes.

***Parmaku** -rrezja e dorës që është në formë të diellit e që është e lidhur me kohën e lashtësisë, që nga lliret të cilët kanë besuar në Kultin e Diellit.

PRIZREN
doors

FJALË TË URTA

Fshat e zanat, derë e tabiat. (Kavajë)

Derë e botës s'është strehë e kokës. (Jug)

Këtej të pi verën, andej të shan derën.

1. Dera - Familja Drini

Rr. "Ardian Zurnaxhiu" Nr. 18, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 210 cm

Gjerësia: 274 cm

Përbërja: 56 pulla, parmaku-hallka, mekanizmi i çelësit apo munxi dheshuli-rrezja në formë të gjarpërit.

Pronari i shtëpisë z. Mustafa Drini, i lindur në vitin 1928, e kujton këtë derë që nga fëmijëria e tij. Ai tregon se dera ka pasur vetëm një ndryshim pas luftës, në zgjerimin e saj horizontal duke ia shtuar një pjesë drurore në gjerësi prej 40cm, për shkak të nevojës për hyrje të automjeteve në oborr.



2. Dera - Familja Celina

Rr. "Ardian Zurnaxhiu" Nr.32, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 240 cm

Gjerësia: 140 cm

Përbërja: dera është e ndërtuar nga druri, ka një shul-rrezën e vogël, pjesa e sipërme përbëhet nga xhami dhe veçohet për pragun e saj në lartësi prej 15 cm që ne vitet e kaluara ishte vend i preferuar për fëmijët e lagjes.



3. Dera - Familja Zhelta

Rr. "Ardian Zurnaxhiu" Pn., 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 173 cm

Gjerësia: 112 cm

Dera ka kasën e vjetër dhe ka shërbyer për bagëti, tani ajo nuk shfrytëzohet më.



4. Dera - Familja Dorambari


Rr. "Bayrakli" Nr.16, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 205cm

Gjerësia: 171cm

Përbërja: 40 pulla te hekurit, parmaku-hallka, mekanizmi i çelësit dhe çelësi jofunksional, si dhe pjesa e sipërme e derës është e vazhduar me dritare në gjatësi prej 84 cm.

Dera karakterizohet me zhvillime historike gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku janë mbajtur takime në mes të figurave udhëheqëse politike të asaj kohe në qytetin e Prizrenit.



5. Dera - Familja Bajmaku

Rr. "Vatrat Shqiptare" Nr.42, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 232cm

Gjerësia: 197cm

Pragu: 26cm

Përbërja: 48 pulla të hekurit (një mungon), munxi apo mekanizmi i çelësit është i veçantë , ka një litar tërheqës dhe një mekanizëm të hekurit për t'a hapur derën. Për shkak të disa tentimeve përvjedhje, pronari i shtëpisë e ka larguar nga dera dorezën e gdhendur nga bronzi.



6. Dera - Familja Llokvica

Rr. "Vratat Shqiptare" Pn., 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 204cm

Gjerësia: 216cm

Përbërja: 28 pulla të hekurit, çoku-tak taku , 2 hallka të vogla në pjesën e sipërme dhe parmaku- hallka.



7. Dera - Familja Bajrami

Rr. "Bayrakli" Nr.14, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 263cm

Gjerësia: 210cm

Përbërja: 38 pulla të hekurit, dorëza për tërheqje, litari tërheqës për hapjen e derës, munxi-mekanizmi i hekurit së bashku me çelësin. Dera karakterizohet me një gdhendje në varg të gjethive në të dy krahët apo kanatet në formë të drejtkëndëshit. Në pjesën e sipërme dera ështe e mbuluar me një strehë të drurit me ngjyrë të gjerlbër dhe me një gavrim të jashtëm.



8.Dera - Familja Shukriu


Rr. "Bayrakli" Nr.13, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 222cm

Gjerësia: 192cm

Pragu: 5cm

Përbërja: 48 pulla të hekurit, parmaku-hallka, çoku-tak taku, litari tërheqës për hapjen e derës, 4 shufra të hekurit, munxi – mekanizmi i hekurit së bashku me çelësin, një shufër e gjatë e hekurt e vendosur në kanatin e majtë mbrapa derës, si dhe shullirrezja me një model unik në formë të gjarpërit.



9. Dera - Familja Morina

Rr. Marin Barleti, Nr. 30. Prizren 20000 Kosova

Gjerësia: 168cm

Gjatësia: 272cm

Dera ka dy kanate, me një karakteristik të veqant në pjesen e siperme të deres eshte harku i punuar me nga hekuri ne forme te dritares. Zoja Shukrije Morina tregon se që nga viti 1972 kur hyri nuse nga kjo derë, çdo pasdite nga ora 18:00 të gjitha grat e moshuara shqiptare dhe sérbe kanë dal para derës dhe janë ulur duke pritur që nuset e lagjës t'u shërbenin me kafe dhe çaj.




10 .Dera - Familja Demiri

Rr. "Vratat Shqiptare" Nr.50, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 197 cm

Gjerësia: 265 cm

Përbërja: 62 pulla të hekurit, 3 kanate, 2 parmaqe-hallka, çoku-tak taku.



11 .Dera - Familja Gorda

Rr. "Hafes Ismahil Hakki" Nr.37, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 206cm

Gjerësia: 219cm

Përbërja: 48 pulla të hekurit dhe munxi-mekanizmi i hekurit për hapjen mbrapa derës.



12 .Dera - Familja Rekathati

Rr. "Ali Pashë Elbasani" Nr.12, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 210cm

Gjerësia: 212cm

Përbërja: 75 pulla të hekurit, çoku-tak taku, parmaku-hallka dhe shuli-rrezja për përforcimin e mbylljes së derës.



13 .Dera 1 - Familja Gjejshylmedine

Rr. "Nikola Tesla" Nr.108, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 163cm

Gjerësia: 188cm

Përbërja: 24 pulla të hekurit dhe çoku-tak taku.

Dera 2- Familja Gjejshylmedine

Gjatësia: 165cm

Gjerësia: 224cm




14 .Dera-Familja Hoti

Rr. "Destan Bellusha" Nr.52, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësi: 225cm

Gjerësi: 204cm

Përbërja: 48 pulla të hekurit, çoku-tak taku, parmaku-hallka, shulli-rrezja në formë të gjarpërit, mekanizmi për hapjen e derës nga druri si dhe litari tërheqës për hapjen e derës.




15 .Dera - Familja Kirajtani

Rr. "Shuaip Spahiu" Nr.15, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 254cm

Gjerësia: 240cm

Përbërja: 43 pulla të hekurit, çoku-tak taku si dhe në vete ka dhe një derë të vogël. Dera ka pasur një rivendosje gjatë vitit 2011 për arsyet e ndryshimeve tokësore. Dera e vogël shfrytëzohet për lëvizjet e përditshme, ndërsa me hapjen e dyerive të mëdha, kusherinjt dhe miqt e familjes kuqtojnë që shtëpia ka ditë gëzimi ose ditë vajtimi.



16 .Dera - Familja Bardhi

Rr. "Shuapi Spahiu" Nr.33, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 199cm

Gjerësia: 200cm

Përbërja: 35 pulla të hekurit, parmaku-hallka dhe çoku-tak taku.

33

17 .Dera - Familja Turtulla

Rr. "Shuaip Spahiu" Nr.32, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 205cm

Gjerësia: 238cm

Përbërja: 41 pulla të hekurit, litari tërheqës për hapjen e derës, çokutak taku në formë të dorës, dhe nga ana e prapme e derës qëndrojnë në mënyrë diagonale shufrat e gjata të hekurit nga muri në të dy anët e derës.



18 .Dera - Familja Mustafa

Rr. "Saraçët" Nr.9, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 215cm

Gjerësia: 218cm

Përbërja: 56 pulla të hekurit, çoku-tak taku, parmaku-hallka, litari tërheqës për hapjen e derës, munxi-mekanizmi i hekurit për hapjen e derës, vrima për çelës dhe shuli-rrezja në formë të gjarprit. Z. Fikret Mustafa tregon se shuli-rezja në formë të gjarprit paraqet veçantinë e derës që shërbënë për ta përforcuar mbylljen e saj. Kjo paraqet një lidhje historike nga kohët e lashta, ku me kultin e gjarprit simbolizohet mbrojtësi i shtëpisë.



19 .Dera - Familja Arapi

Rr. "Saraçët" Nr.16, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 220cm

Gjerësia: 221cm

Përbërja: 31 pulla të hekurit, 2 parmaqe-hallka, çoku-tak taku, mekanizmi prej hekurit për mbylljen të derës dhe shuli-rezja në formë të gjarprit.



20. Dera - Familja Grazhda

Rr. "Fehmi Lladrovci" Nr.46, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 224cm

Gjerësia: 228cm

Përbërja: 64 pulla të hekurit, çoku-tak taku, parmaku-hallka, shuli-rezja
në formë të gjarpërit dhe patkoi- simbol i fatit të mirë.



21. Dera - Familja Mangovski

Rr. "Besnik Muçaj" Nr.23, 20000 Prizren, Kosovë

Përbërja: 14 pulla të hekurit, 2 doreza hekuri në mënyre vertikale në të dy kanatet, vrima dhe mekanizmi i vogël i hekurit për çelës.



22. Dera - Familja Gjelani

Rr. "Hysen Rexhepi " Nr.16, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 217cm

Gjerësia: 214cm

Përbërja: 42 pulla të hekurit, çoku-tak taku, mekanizmi i hekurit prapa derës dhe shuli-rezja në formë të gjarpërit.



23.Dera - Muhamed Aga (e braktisur)


Rr. "Kurilla" Nr.6, 20000 Prizren, Kosovë

Gjatësia: 190cm

Gjerësia: 183cm

Pragu: 20cm

Përbërja: 32 pulla të hekurit dhe parmaku-hallka.



24. Dera - Familja Morina

Rr.Tahir Meha.Nr.27.Prizren 20000 Kosova

Gjerësia: 227cm

Gjatësia: 236cm

Pragu: 24cm45 pulla të mëdhaja të hekurit, litari tërheqës për hapjen e derës, mandallin e drurit për bllokimin e kanateve, mekanizmin e hekurit për hapje të derës i cili është jofunksional, shul-rezja në formë të gjarprit, shufrën e gjatë të hekurit prapa derës vetëm në njëren anë



25. Dera - Familja Dukagjini

Rr.Sheshi Lidhjës.Nr.27.Prizren 20000 Kosova

Gjerësia: 220cm

Gjatësia: 208cm

52 pulla të vogëla të hekurit , munxi-mekanizmi i hekurit për hapje të derës, dy shufra të hekurit të gjata në pjesën e prapme të derës për përforcim , si dhe një veçanti e kësaj dere është gdhendja në formë të luleve në mes të dy kanateve.



26. Dera - Familja Kastrati

Rr.Papa Gjon Pali II.Nr.15.Prizren 20000 Kosova

Gjerësia: 182cm

Gjatësia: 190cm

28 pulla të hekurit, parmakun-hallkën, shul-rezja për përforcimin e mbylljës së derës, dera nuk ka pas ndryshime, kujtohet nga pronarët nga viti 1963 atëherë edhe kur e kan blerë shtëpin



P R I Z R E N d o o r s

Botues: EC Ma Ndryshe

Autore: Valtida Shukriu Marseli

Rr. Fehmi Lladrovci, Nr. 94, Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

029-222-771 & 038-224-967

2019

